**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0035074-8.2/26
29.06.2026

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0035074-8.2/26 dt. 29.06.2026**
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17, pika g, pika j, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); në nenin 37, 57, 90 dhe 91, të Ligjit Nr. 04/L-027 Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 22/2011); nenet 12, 29, 30, dhe 31, të Rregullores Nr. 17/2015 Për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 29.06.2026, pasi shqyrtoi Raportin mbi vlerësimin e dëmeve nga zjarret gjatë vitit 2025, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0034897-5/26 dt. 26.06.2026), sjell këtë:

**VENDIM**
**Për miratimin e Raportit Nr. 11-052/01-0064534/25 dt. 17.10.2025 mbi vlerësimin e dëmeve nga zjarret gjatë vitit 2025**

1. MIRATOHET Raporti Nr. 11-052/01-0064534/25 dt. 17.10.2025 mbi vlerësimin e dëmeve nga zjarret gjatë vitit 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti Nr. 11-052/01-0064534/25 dt. 17.10.2025 mbi vlerësimin e dëmeve nga zjarret gjatë vitit 2025.
3. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

**Dorëzohet:**
**1 x 1** **Kryesuesit të Kuvendit**
**1 x 1** **MAPL-së**
**1 x 1** **Arkivit**
**Kopje:** **Kryetarit të Komunës**
**DSE-së**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 03.10.2025 11.052/01-0064534/21 |
| **REFERENC-Ë:** | 17.10.2021 |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **D.S.E Bahtir Maxhuni Drejtor** |
| **NGA:** | **Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Zjarret 2025 në Komunën e Mitrovicës Jugore** |
| | **Raport i përgjithshëm!** |

Me dt 08.09.2025 ishim për vizitë në bazë të kërkesës së z. Nehat Sahiti dhe pamë nga afër dëmin që I është shkaktuar nga zjarri në muajin korrik në pemishten e tij, pemishtja është 17 vjeçare më tepër se 1000 trupa me pemë të ndryshme. Zjarri që ka kapluar këtë pemishte ka qenë nga pakujdesia e ndonjë individi dhe ka kapluar tërë pemishten mirëpo në masë më të madhe I janë dëmtuar 63 trupa pemë, prandaj konstatojmë se dëmi total është 63*150€ =9,450.00€





Me dt,08.09.2025 ishim për vizitë në fshatin Vaganicë në bazë të kërkesës së z. Sadik Lushtaku dhe pamë dëmin që i është shkaktuar në pemishten e tij si shkak I pakujdesisë së ndonjë personi.

Zjarri që kishte kapluar pronën e tij e kishte dëmtuar edhe serrën (folin) arrin vlerën 300.00 € gjithashtu kishte kapluar edhe pemishten ku janë dëmtuar 25 trupa pemë të ndryshme ,një arrë shumë vjeçare në vlerë 150.00 €

14 trupa tjera më të vjetra se 10 vjeçare (14*150€) = 2,100.00 € ndërsa 10 trupa kanë qenë fidanë të reja që vlerësohen 10*20€=200€

Që dmth dëmi i përgjithshëm është 2,750.00€







Dëmet në fshatin Vaganicë si pasojë e zjarreve janë:

z.Sadik Lushtaku në vlerë 2,750.00 €

z. Nehat Sahiti në vlerë 9,450.00 €

Kemi qenë tek z. Murat Brahimi ku si pasoj e zjarreve gjate muajit gusht në fshatin Kçiq I Madh zoteriut në fjalë i janë dëmtuar 15 koshere bletësh në vlerë 45.00 €*15= 675.00 € dhe i është djegur centrifuga që kushton 250.00 €.

Gjithsejtë dëmi i shkaktuar është: 925.00 €





Kemi dalur në vizitë te z. Liridon Selmani të cilit si pasojë e zjarrit fushor I është djegur serra si në vijim:

Llastiku I serrës në vlerë 1,000.00 €

Sistemi I ujitjes 300.00 €

Folja e zezë 300.00 €

Mjete të punës 200.00 €

Instalimi I rrymës komplet me gjithë njehsor 450.00€

Rrjetë hijezimi 100.00 €

Module për fara 100.00 €

Amballazh 100.00 €

Sistern për ujitje me komplet pajisjet 200.00 €

Dëme në bimë 200.00 €

Plehra kimik me pesticide 150.00 €

Dy rrjeta rrethoja 55.00 €

Gjithsejtë: 3,155.00€





**Gjithsejtë dëmi i shkaktuar është: 16,280.00 €**

Komisioni Komunal:

1. Besim BEKA -Kryetar
2. Rexhep HAJDARI -anëtar
3. Idriz BEQIRI-anëtar
4. Jeton BAJRAMI-anëtar
5. Bahri SINANI-anëtar

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA MITROVICA
MITROVICË-MITROVICA